



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 336/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Burim Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e **Xhemile Avdyli me vendbanim në Gjermani**, për shkak të refuzimit të aplikacionit për tu regjistruar në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më 05.02.2021, mori këtë:

VENDIM

Hidhet i pasafatshëm apeli i Xhemile Avdyli me vendbanim në Gjermani, mbetet në fuqi vendimi KQZ-së me nr. 419-2021 i datës 02.02.2021 për Përfshirjen e Votuesve të Aprovuar në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendlindit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2021.

Arsyetim

Më **04.02.2021 15:40** PZAP-i, ka pranuar një apel nga **Xhemile Avdyli me vendbanim në Gjermani**, kundër vendimit të KQZ-së, me të cilin i është refuzuar aplikacioni i tij/saj që të përfshihet në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës.

Paneli, pasi që shqyrtoi afatshmërinë e apelit konstatoi se:

Apeli është i pas afatshëm

Paneli, konstatoi se apeli i parashtruar nga **Xhemile Avdyli**, është i pas afatshëm sepse ndaj vendimeve të KQZ-së, sipas nenit 122.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), afati për të parashtruar apel në PZAP, ndaj vendimeve të KQZ-së, është 24 ora, nga momenti i pranimit të vendimit nga pala e interesuar ndërsa pala vendimin e KQZ-së, e ka pranuar me dt. **02.02.2021** dhe ka parashtruar apel në PZAP, me dt. **04.02.2021 15:40**, nga kjo del se apeli është i pas afatshëm ngase kanë kaluar më shumë se 24 orë nga momenti i pranimit të vendimit të KQZ-së, prandaj Paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)
Anr. 336/2021 më datën 05.02.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi lejohet ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-it.